



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. 2020

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall vend të lirë pune për:

- **1 (një) Specialist Fusha e Mjekësisë/Ekonomi në Degën Lushnje pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Fier.**

Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Fier janë:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo shërbimi Civil për thyerje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të ketë mbaruar Fakultetin e Mjekësisë/Ekonomi;
- Të jetë i komunikueshëm dhe të ketë aftësi të punës në grup;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja do të jetë avantazh (preferohet anglisht);
- Të zotërojë kompjuterin;
- Nota mesatare do të jetë avantazh.

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Fier, **brenda datës 30.06.2020**, këto dokumenta;

- Kërkesë për punësim;
- Përshkrimin e edukimit dhe karrierës profesionale (curriculum vitae)
- Diplomë e noterizuar
- Diplome master e noterizuar;
- Listë notash e noterizuar;
- Dëshmi për kualifikime të ndryshme si kurs kompjuteri, gjuhën e huaj;
- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar ;
- Librezën e punës (fotokopje) ;
- Kartë identiteti (fotokopje) ;
- Dëshmi penaliteti (të datojë brenda 3 muajve të fundit) ;
- Raport mjekësor për aftësi në punë.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet në sekretari.

Adresa:

Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Fier.

Lagjia: “1 Maji”, Rruga “Jani Bakalli”, Tel. 034 222 145